



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2018/2 Prot

Tiranë, më 23/11/2021

VENDIM

Nr. 61, datë 23.12.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2018 Prot., datë 07.12.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet shkresës datë 19.10.2021, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, lidhur me:

- Nëse kompania “Bankers Petroleum Albania Ltd” është gjobitur ndonjëherë ndër vite, në ç’shumë dhe a i ka shlyer këto detyrime.

Autoriteti Publik nëpërmjet shkresës nr. 18672/1 Prot., datë 23.11.2021, ka sqaruar se: “...të dhënat e përcaktuara në vendimet administrative për përcaktimin në vlerë të sanksioneve administrative janë të natyrës konfidenciale referuar nenit 20 pika 1, paragrafi i parë i ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili sanksionon se, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 48, ky informacion nuk jepet nga autoritetet kompetente doganore, pa lejen e shprehur të personit ose autoritetit që e ka dhënë atë. Njëkohësisht, referuar edhe nenit

17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili në pikën 2, germa "dh" sanksionon se: "E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor."

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI") dhe ankuesja legjitimohet në kërkimin e saj.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI në të cilin citohet se: *"Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve",* me shkresën nr. 2018/1 Prot., datë 10.12.2021, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua më datë 16.12.2021 me prezencën e ankueses dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në shkresën nr. 18672/1 Prot., datë 23.11.2021.

Konkretisht, Autoriteti Publik ritheksoi faktin se, ka ezauruar në përmbushje të plotë të legjislacionit në fuqi trajtimin dhe informimin e kërkesave të parashtruara nga kërkuesja, duke argumentuar ndër të tjera se: *"... Përgjatë këtyre viteve mbikëqyrje doganore si dhe nga kontrollet doganore janë hasur edhe raste kur operatori ekonomik nuk ka respektuar dispozita të Kodit Doganor dhe/ose Ligjit për Akcizat, e rast pas rasti autoritetet doganore kompetente kanë mbajtur qëndrimin e tyre ligjor duke marrë vendimet administrative përkatëse me gjoba që variojnë sipas parashikimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Në të gjitha rastet kur janë vendosur penalitetet për këtë operator ekonomik nga administrata doganore është arkëtuar detyrimi i munguar doganor si edhe sanksionet administrative, përveç një rasti i cili është në proces gjyqësor. Ndërsa referuar pjesës së dytë të kërkesës për informacion, lidhur me shumën e detyrimeve doganore dhe të penaliteteve vlerësojmë se, të dhënat e përcaktuara në vendimet administrative janë të natyrës konfidenciale referuar nenit 20, pika 1 paragrafi i parë i ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.*

Njëkohësisht referuar edhe nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 të LDI i cili në pikën 2 germa "dh" sanksionon: "E drejta për informim kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor", nuk mund të përcjellim informacion lidhur me vendime administrative doganore të cilat janë në proces gjykimi nga gjykatat në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, referuar ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar (ligj me të cilin rregullohen marrëdhëniet e punës në administratën doganore), nëpunësi civil ka detyrimin të sigurojë mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave vetjake dhe atyre që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të personave, të mbrojtura sipas ligjit dhe me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në nenin 18, pika 1 dhe 2 sanksionohet përkufizimi i sekretit tregtar dhe rastet kur një informacion nuk përbën sekret tregtar. Në konkluzion të sa më sipër, sa i takon shumave të detyrimeve doganore, Autoriteti Publik vlerëson se kërkesja duhet ti drejtohet operatorit ekonomik ose të sigurojë dhënien e pëlqimit dhe përcjelljen pranë autoriteteve doganore sipas parashikimeve ligjore sipërcituar."

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i kërkoi përfaqësuesve të Autoritetit Publik për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur, brenda datës 20.12.2021, në përputhje me vendimet e marra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për çështje të ngjashme.

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 21.12.2021 vuri në dispozicion të Komisionerit rastet në të cilat konstatohet fakti që është në proces gjyqësor me operatorin ekonomik.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, i rikonfirmuar me shkresën e datës 16.12.2021 (depozituar në seancën dëgjimore) nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *"Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj".*

Në kuptim të këtij parashikimi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Nga përgjigja e Autoritetit Publik konstatohet se, refuzimi i dhënies së informacionit është bërë mbi bazën e pikës 1 të nenit 20, paragrafi i parë i ligjit nr. 102, datë 31.07.2014, "Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sipas qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik, të dhënat e përcaktuara në vendimet administrative për përcaktimin në vlerë të sanksioneve administrative janë të natyrës konfidenciale, duke përjashtuar *a priori* çdo individ që kërkon akses sipas dispozitave të LDI.

Gjithashtu, ky i fundit argumentat e tij i bazon në shkronjën b), të pikës 1, të nenit 17 të LDI në të cilën parashikohet se: *"E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: b) sekretin tregtar", duke mos provuar në asnjë moment, se si çënohet sekreti*

tregëtar, bazuar në këtë dispozitë për të mbështetur qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Në nenin 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të cituar edhe nga Autoriteti Publik, konstatojmë se, në dispozitën përkatëse është përcaktuar qartë kufiri i sekretit tregtar, i cili përfshin vetëm informacionin e brendshëm. Megjithatë, në pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji parashikohet se: *“2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik”*. Sipas të gjithë kuadrit ligjor në fuqi përqindja e dominimit të kompanisë në një treg të caktuar nuk përfshihet në sekretin tregtar.”

Gjithashtu, Autoriteti Publik, për çështjet gjyqësore që janë në proces, argumenton se ky informacion, bazuar në shkronjën b) të pikës 1, të nenit 17 të LDI, nuk mund të vendoset në dispozicion. Fakt ky, që u provua me e-mail-in dërguar pas seancës dëgjimore, ku vendosi në dispozicion çështjet gjyqësore në proces. Lidhur me këtë pjesë të dokumentacionit, Komisioneri mbështet pretendimin e Autoritetit Publik si argument të mbështetur në ligj.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 2018 Prot., datë 07.12.2021 të znj. _____, kundër Autoritetit Publik “Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, duke respektuar nenin 17 të LDI, mbi kërkesën për informacion të datës 19.10.2021, konkretisht: (Nëse kompania “Bankers Petroleum Albania Ltd” është gjobitur ndonjëherë ndër vite, në ç’shumë dhe a i ka shlyer këto detyrime) brenda datës 31 .12 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 23 .12 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

